



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Prezantimi i projektligjeve të paketës fiskale:
 - “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;
 - “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”;
 - “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012 ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
 - “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Sot në rendin e ditës të punës së këtij komisioni kemi katër çështje: diskutimin në parim të projektligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe shqyrtimin e projektligjeve “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”; “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Fillojmë menjëherë me shqyrtimin e projektligjit të parë “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”. Do të procedojmë me prezantimin e këtij projektligji nga ana e ministrit, për të vazhduar me zotin Ervin Bushati, i cili do të relatojë, në emër të komisionit, për këtë projektligj, për ta mbyllur me pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Fjalën e ka ministri për Ekonominë dhe Financat.

Arben Ahmetaj – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Para jush vjen projektligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar”, ndryshimet e të cilit synojnë nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e dixhitalizimit të medieve audiovizive dhe kontrollin më të mirë të tyre, që deri tani kanë qenë të përjashtuara; nxitjen dhe zhvillimin e transportit publik të gjelbër, duke zëvendësuar autobuzët e transportit publik me naftë në ato elektrike (pra synimi); mbështetjen e sektorit të bujqësisë, duke lehtësuar kostot e investimit; adresimin e kërkesës së industrisë fason për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar kostot e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

Këto janë ndryshimet që kemi ofruar për sa i përket tatimit mbi vlerën e shtuar. Mbetem në dispozicionin tuaj për pyetje ose komente.

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” parashikon ndryshimet si më poshtë.

Në nenin 1 të projektligjit propozohet shtimi i dy pikave të reja në nenin 49 të ligjit bazë. Nëpërmjet këtyre shtesave parashikohet: “1. Nxitja dhe lehtësimi i investimeve në fushën e dixhitalizimit të medieve audiovizive nëpërmjet aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së në nivelin 6% për furnizimin e shërbimit të reklamave nga mediet audiovizive dhe televizionet. Nëpërmjet kësaj politike vlerësohet se do të stimulohen dhe do të lehtësohen investimet në kuadër të dixhitalizimit të medieve audiovizive.

2. Nxitja dhe zhvillimi i transportit publik të gjelbër, pra transportit ekomiqësor, që nuk ka ndikim negativ në mjedis, duke propozuar aplikimin e një shkalle të reduktuar të TVSH-së, në nivelin 10%, për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobusë, me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motorë elektrikë. Kjo politikë vlerësohet se do të ndihmojë në stimulimin e zëvendësimit të autobusëve me naftë në autobusë elektrikë”.

Në nenet 2 dhe 3 të projektligjit parashikohen lehtësi për prodhimin vendas, nëpërmjet mbështetjes së sektorit bujqësor, me anë të lehtësimit të kostove të investimit, duke përfshirë kategorinë e veprimtarive me interes të përgjithshëm, të përjashtuar nga TVSH-ja, edhe atë të furnizimit të makinave bujqësore, i cili aktualisht është furnizim i përjashtuar vetëm në import. Përjashtimi do të funksionojë sipas së njëjtës listë makinash bujqësore, të miratuara me vendimin nr. 953 të vitit 2014 të Këshillit të Ministrave, dhe do të lehtësojë kostot e investimit në sektorin bujqësor; përfshirje në listën e furnizimit të përjashtuar nga TVSH-ja dhe të nënkontraktorëve, nënoperatorëve të shoqërive mbajtëse të autorizimit të përpunimit aktiv, siç quhet ndryshe industria fason, të cilët nënkontraktohen për kryerjen e një ose disa operacioneve përpunuese. Në këtë mënyrë unifikohet trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja si për operatorin ekonomik që mban autorizimin, pra atë primarin e përpunimit aktiv, ashtu edhe nënkontraktorin e tij, në qoftë se është sekondar ose vazhdon.

Neni 4 i projektligjit parashikon një dispozitë të re, me qëllim stimulimin e zhvillimit të industrisë vendase të prodhimit të barnave, nëpërmjet uljes së kostos së prodhimit, duke përfshirë si përjashtim të veçantë në import edhe importimin e lëndëve të para që përdoren për importimin e barnave, me përjashtim të lëndëve të para me përdorim të dyfishtë. Lista e këtyre lëndëve të para do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për shkak të shtimit të lehtësirave fiskale, që ky projektligj synon të mundësojë, parashikohet të ketë një efekt buxhetor që vlerësohet përafërsisht në masën në ulje, me minus

300 milionë lekë, por që parashikohet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që stimulohen dhe lehtësohen.

Gjithashtu, pavarësisht lehtësirave që ky projektligj parashikon dhe lidhur me debatin që patëm dje mendoj që, siç kemi evidentuar edhe në seancat e mëparshme, të sugjerojmë që të merret parasysh mbështetja që do të jepet për bujqësinë për një nga sektorët kryesorë të ekonomisë dhe që mbulon një pjesë të madhe të shoqërisë, si dhe të shikojmë zbatimin konkret të angazhimeve të ndërmarra në vite për uljen e inputeve të TVSH-së tek inputet bujqësore.

Përfundimisht, duke e vlerësuar këtë projektligj si një paketë lehtësuese, ftoj kolegët ta votojnë atë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka pyetje?

Po, urdhëroni!

Ervin Bushati – Për sa i përket pikës së parë, kërkoja edhe në dokumente, dua të di efektin financiar për uljen e TVSH-së në nivelin 6% për reklamat, në qoftë se keni ndonjë shifër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Efektin financiar.

Arben Ahmetaj – Do t’jua vëmë në dispozicion kur ta diskutojmë nen për nen.

Ervin Bushati – Kam edhe një sugjerim, që ndoshta mund ta kthej në pyetje. Te pjesa: “Kjo politikë vlerësohet se do të ndikojë në stimulimin dhe zëvendësimin e autobusëve me naftë në autobusë elektrikë”, unë sugjeroj të vihet “motorët me djegie të brendshme”, ku bëjnë pjesë të gjithë karburantet fosile, se mund të jetë edhe me gaz, edhe me benzinë. Pra, jam i mendimit të mos lihen thjesht ato me naftë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është një propozim që e kam mbajtur shënim.

Këto kisha.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Logjika e uljes i referohet një kategorie shumë specifike, pra autobusëve publikë elektrikë. Kështu që, automatikisht e kufizon të gjithë kategorinë.

Ervin Bushati – E kisha thjesht për saktësim, meqenëse përdoret sot gjithandej.

Arben Ahmetaj – E qartë.

Ervin Bushati – Kisha vetëm këtë sugjerim për përmirësim.

Arben Ahmetaj – E qartë.

Erion Braçe – Kaq kishit ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka pyetje të tjera? Urdhëroni, zoti Xhelilaj!

Roland Xhelilaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje, e cila lidhet me vëmendjen tejet korrekte të adresimit të kërkesës së industrisë fason për përjashtimin nga tatimi i vlerës së shtuar. Dua të trajtoj këtu ose të marr një përgjigje: a janë marrë në konsideratë edhe subjektet nënkontraktore, që lidhen me ato subjekte që po punojnë materialin që vjen nga porositësit, të cilët janë edhe nënkontraktues, që kanë të bëjnë, për shembull, me rrobaqepësitë, me ngjyrosjen, me lavanteritë, të cilat me këtë lloj trajtimi penalizohen për kreditimin e TVSH-së?

Arben Ahmetaj – Ndryshimi që kemi ofruar vjen si rezultat i kërkesës së industrisë për shkak të vështirësive që kanë, pra të zinxhirit të vlerës që krijojnë dhe të vonesave në transaksionet me njëra-tjetrën, që nuk përputhin periudhën kohore të rimbursimit të TVSH-së; ky është thelbi i problemit. Kjo do të thotë që, për të mos e pasur këtë ngërç me nënkontraktorët, ne po i përjashtojmë ata. Sigurisht, ka pasur edhe kërkesa për ta pasur zero, por ajo do ta deformonte instrumentin e TVSH-së në rastin konkret. Kështu që kemi kthyer logjikën e përjashtimit.

Sigurisht që ka dhe ju, me të drejtë, përmendët një nga proceset që është vetë puna. Kur ta kalojmë projektligjin nen për nen, do ta risjellim këtë diskutim, por do të duhet të kemi kujdes që të mos cenojmë kuadrin e TVSH-së në procedurën e aplikimit, por edhe të kontrollit, se pastaj në vend që të përmirësojmë procedurën, e komplikojmë atë. Gjithsesi, do ta rishohim kur të vijmë nen për nen.

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Bushaj dhe pastaj zonja Kushi.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për shpjegimin dhe ekspozenë që i bëtë këtij projektligji!

E vlerësoj maksimalisht përjashtimin nga TVSH-ja të mjeteve bujqësore, por dua të pyes: si do të veprohet me TVSH-në për ato mjete që janë gjendje nëpër pikat e tregtimit të mjeteve bujqësore? Ndoshta ministritë, apo qeveria do të nxjerrin udhëzimet përkatëse, por do të doja të dija që në fillim se si do të veprohet me stoqet që ato kanë në pikat e tregtimit të mjeteve bujqësore.

Arben Ahmetaj – Në rastin konkret ndryshimet ligjore nuk kanë efekte prapavepruese, pra nuk kanë retrospektivë, aq më shumë edhe për faktin që ato janë transaksione të mbyllura dhe të deklaruara tashmë, qoftë brenda bilanceve, qoftë me bilancet fiskale. Thënë kjo, praktikisht nga 1 janari, nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit dhe më pas, do të trajtohet kështu siç e kemi parashikuar.

Ju e dini që ka pasur një problem, sipas meje një deformim i tregu. Pra, nëse je fermer dhe e blen makinerinë bujqësore jashtë Shqipërisë dhe e importon, je i përjashtuar nga taksat.

Ndërkohë, në qoftë se je sipërmarrës që tregon makineri bujqësore, e blen në Itali apo kudoqoftë tjetër, ke detyrimin ta importosh me TVSH dhe më pas, unë si fermer, do të më duhet ta blej te tregtari me TVSH, pra më duhet të them se është një trajtim i pazakontë.

Unë besoj se ka qenë një lapsus i ligjit në momentin, kur është riparë në total përpara 4 vjetësh. Gjithsesi, ne e kemi diskutuar edhe me industrinë, edhe me sektorin. Besoj se kjo e korrekton komplet atë kundërshti që ka pasur.

Për sa i përket problematikës në të kaluarën, nuk ka fuqi prapavepruese.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi - Faleminderit, kryetar!

Natyrisht, kur bëhet fjalë për ndotjen e mjedisit dhe veçanërisht për ndotjen e ajrit, ndjeshmëria publike është shumë e lartë. Kështu që, unë e mirëpres dhe e përshëndes vendimin për uljen e TVSH-së për furnizimin me autobusë elektrikë nga 20% në 10%.

Desha të di sa efekt do të ketë kjo masë? Si janë pritshmëritë? A është bërë një analizë se kur mund t'i presim efektet për zëvendësimin e këtyre autobusëve?

Ideja është mos ndoshta kjo duhet të shoqërohet edhe me masa të tjera në mënyrë që kjo të ketë efekt të plotë, sepse është fjala jo vetëm për Tiranën, por edhe për qytetet e vogla.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Nëse mundem, për çfarë masash e keni fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi bërë një analizë, madje unë personalisht kam bërë edhe përllogaritjen e kursimit të kombinuar midis asaj që kursehet nga 10-përqindëshi i TVSH-së dhe asaj që kursehet nga mospërdorimi i karburantit.

Në momentin që çmimet e autobusëve elektrikë janë akoma të lartë për shkak të standardizimit akoma modest të industrisë së prodhimit të tyre, autobusët elektrikë janë pak

më të shtrenjtë sesa autobusët tradicionalë, por nga përlllogaritja jonë në 5 vjet, jo pa arsye kam marrë 5 vjet, sepse mendohet që është një term kohor normal i amortizimit të plotë, kursehen rreth 195 mijë euro, që barazon sot çmimin pak të lartë të autobusëve elektrikë, me kursimin ndër vite që realisht vjen me çmimin e sotëm të autobusëve tradicionalë me naftë. Sigurisht, industria do të prodhojë më lirë ndër vite. Kjo është eksperiencë e vjetër dhe kuptohet që kursimi do të jetë akoma më i madh. Kjo është analiza e parë.

Analiza e dytë, do të shoqërohet me kondicione dhe me bonuset, që do të ofrojnë njësitë vendore. Unë e kam biseduar me disa bashki dhe bashkitë do të vendosin bonuse në licencim për autobusët elektrikë dhe sigurisht, dalëngadalë, do të fillojë të kthehet edhe në një kondicion ligjor, por kjo do të bëhet gradualisht.

Ne tani po hedhim një farë dhe po shohim se si do të funksionojë politika e miksuar fiskale me atë ambientale.

Kryesisht, në Europë, që është shumë më e avancuar në këtë drejtim, në përgjithësi punojnë me *rebat* (bonus). Pra, në përgjithësi nuk e prekin nivelin e TVSH-së, por ecin me një taksë direktive, që është TVSH-ja rreth 14%. Kur them “taksë direktive”, kjo është referenca që bëjnë direktivat e BE-së dhe përdorin bonuse.

Po jua ilustroj. Kush importon, shet, ose blen, një makinë elektrike, përveçse e ka TVSH-në rreth 14%, merr mbrapsh një *rebat*, një bonus 3-4-5-6 mijë euro. Kjo ndodh për të mos e prishur strukturën e TVSH-së, por edhe për ta kontrolluar më mirë, sepse sa më shumë lëshon nga taksat, aq më pak mund ta kontrollosh nga ana tjetër, të gjithë transaksionin. Këto kanë patjetër një fazë mbarimi si incentiva. Po t’i kthehemi solarit për prodhimin e energjisë, dikur ka pasur subvencione të drejtpërdrejta dhe përjashtime tatimore.

Europa e Bashkuar ka ikur edhe nga subvencionet, edhe nga lehtësitë fiskale. Pse? Sepse industria dhe teknologjia janë kthyer në racionalitetin e kostos dhe të përfitimit, pra teknologjia është bërë më racionale, zëvendësimi ka ndodhur edhe në bazën ligjore, pra me kondicione ligjore dhe kthimi i investimit është bërë më normal. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me makinat elektrike, se tani tentojmë të gjithë të bëjmë sikur po shtyjmë një politikë shumë trendi. Kjo që po bëjmë është normale. Në 7-8-10 vjet nuk do të ketë fare nevojë të ketë bonus. Do të jetë *business as usual*, do të jetë normale dhe nuk do të ketë nevojë as t’i ulësh taksën, as t’i japësh bonus, sepse do të përkthehet në të përditshme. Ne po tentojmë të bëjmë një *shifting* nga kërkesa, po kërkojmë të influencojmë kërkesën nëpërmjet kësaj politike modeste fiskalo-ambientale.

Erion Braçe – Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin!

Në fakt ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj do të sjellin efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve, të cilët preken prej parashikimeve që ju keni në këtë projektligj. Ky projektligj do të sjellë gjithashtu, efekte në buxhet minus 300 milionë lekë. Si mendoni ju ta rikuperoni këtë diferencë në të ardhurat për vitin 2019?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Besoj se këtë përgjigje të detajuar do ta merrni edhe gjatë diskutimit të të ardhurave (të fiskales), të buxhetit për vitin 2019, pra, nga i kemi burimet për parashikimin e të ardhurave për vitin 2019, por në finale ajo që mund të them si përgjigje në parim tani, është që e gjithë përllogaritja jonë e të ardhurave është bazuar në rritjen e sektorëve, rritjen e ekonomisë në tërësi, në profilet e rritjes apo të tërheqjes së produkteve të veçanta, madje deri te niptet, sigurisht edhe me kalkulime standarde makroekonomike të formulave, që unë jam i bindur se ju i dini.

Pra, praktikisht ne kemi bërë dy përllogaritje për të ardhurat: njëra është logjika makroekonomike dhe tjetra nga sektorët deri tek e ardhura totale. Gjithsesi, kur të diskutojmë numrat e të ardhurave, jam gati të kalojë një nga një në të gjitha burimet.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Zoti Ministër, kam unë disa pyetje.

Së pari, çështja e TVSH-së së shërbimit të reklamave në mediat elektronike, nga kjo që është shkruar në relacion, është pak e paqartë. Thuhet që furnizimi i shërbimit të reklamave nga mediat elektronike është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, sipas germës “j” të nenit 53, të ligjit për TVSH-në. Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, këto subjekte nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimeve të përjashtuara. Bëhet fjalë për blerje në funksion të reklamës apo për blerje në funksion të të gjithë aktivitetit radioteleviziv?

Arben Ahmetaj - Bëhet fjalë për të gjitha blerjet. Brenda transaksioneve ne nuk mund dhe nuk do të ishte normale t'i ndanim. Është TVSH-ja e akumuluar në blerje dhe në shitje dhe konsekuenca, për shkak të përjashtimit, i ngelej në kosto dhe nuk arrihej të kontrollohej.

Erion Braçe – Dakord, këtë e kuptoj, por dua të di, veprimtaria radiotelevizive në këtë vend është e përjashtuar nga TVSH-ja apo është përjashtuar thjesht dhe vetëm shërbimi i reklamave?

Arben Ahmetaj – Vetëm reklamat.

Erion Braçe – Po kur e gjithë veprimtaria e radiotelevizionit është në skemën e TVSH-së, çfarë implikon kjo e reklamave?

Arben Ahmetaj – Sepse krijon në të gjithë pjesën e reklamave dhe pjesën e kostos totale Nuk përjashtohen produktet nga njëra-tjetra kur kalkulohet transaksioni. Në përlllogaritjen totale të TVSH-së, transaksioni është në totalin e blerjeve dhe në totalin e shitjeve. Në rastin konkret, një pjesë ngelet brenda si kosto dhe denatyrton transaksionin dhe vlerën zinxhir të TVSH-së. Për mendimin tim, besoj se do të përmirësojë edhe kontrollin për sa i përket kësaj industrie.

Erion Braçe - Keni ndonjë industri tjetër që ka të njëjtin problem?

Arben Ahmetaj – Patjetër që ka disa industri ...

Erion Braçe – Po flas për fushën e medias. Botimet e librave, për shembull.

Arben Ahmetaj – Kemi shtypshkronjat.

Erion Braçe – Botimin e librit, jo thjesht shtypshkronjat

Arben Ahmetaj - Shtypshkronjat, sepse nuk është i gjithë aktiviteti.

Erion Braçe – Po këtë pse nuk e adresoni?

Arben Ahmetaj – Sepse gjërat vijnë gradualisht.

Erion Braçe – Unë mendoj se libri është prioritet shumë më i madh, pavarësisht gallatës që ka shpërthyer këto javët e fundit, sesa...

Arben Ahmetaj – Unë nuk e di gallatën që ka shpërthyer, por besoj se jemi dakord ...

Erion Braçe – Nuk jeni ju përgjegjës për gallatën.

Arben Ahmetaj - Jemi dakord që libri është prioritet dhe është i përjashtuar. E ka kërkuar industria të përjashtuar.

Erion Braçe – Nuk është kështu. Kam marrë disa letra nga shoqatat e botuesve që ...

Arben Ahmetaj – Unë mendoj që ia vlen t'i ndajmë ato letra. Fatkeqësisht, unë nuk kam marrë akoma ndonjë letër. Gjithsesi, nëse ka një shqetësim, e shikojmë në të ardhmen me shumë merak dhe konsideratë.

Erion Braçe – Ndjesë, i ka shkuar Ministrisë së Kulturës, jo juve. Nëse nuk jua ka përcjellë, është tjetër histori.

Arben Ahmetaj – E diskutojmë në vazhdimësi.

Erion Braçe - Pyetja tjetër, që ju pyeti edhe zonja Kushi, lidhet me mjetet elektrike në tërësi, sepse në shërbimin e transportit publik nuk hyjnë vetëm autobusët, por edhe taksitë përgjithësisht. Nga sa kuptoj unë nga relacioni, qëllimi është ambiental.

Arben Ahmetaj – Patjetër, politikë fiskale ambientale.

Erion Braçe – Direktiva e Bashkimit Europian thotë që lejon deri në dy shkallë të reduktuara. Ju pse keni zgjedhur dhjetën kur të gjitha reduktimet po i akomodoni te gjashta?

Arben Ahmetaj – Kjo ka një specifikë si politikë, por edhe si industri. Ne kemi menduar që dhjeta është më racionale. Është e para herë që ne po provojmë një politikë fiskale ambientale.

Duam ta shikojmë si do të aplikohet, si do të veprojë, sa efekte do të ketë, çfarë kërkesash do të ketë, çfarë ndryshimi do të bëj në kërkesë.

Gradualiteti në politikat fiskale ka të bëjë edhe me një element tjetër, që e kemi parë në eksperiencat e vendeve të ndryshme. Kanë bërë politika fiskale ambientale agresive dhe kanë shkuar në nivele, në këndvështrimin tim, papranueshmërisht të ulëta. Kur baza tatimore ka lëvizur e gjitha, në rastin konkret nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile në elektrike, përveç se kanë humbur bazën fiskale, nuk kanë arritur dot t'i rikthehen taksimit normal. Është shumë e vështirë të rikthesh një taksë, qoftë nga ana e politikave fiskale, qoftë nga ana e politikave ekonomike, qoftë nga ana e ndjesisë që kanë qytetarët dhe komunitetet. Kështu që, jemi duke bërë një politikë të kujdesshme: po mbjellim farën për të parë se si do të na funksionojë si politikë. Në vitet që vijnë, jam i bindur që do të jemi shumë më të qartë se si na ka influencuar taksa në funksion të kërkesës dhe në terrenin ekonomik.

Erion Braçe – Faleminderit! Këto ishin pyetjet e mia.

Vazhdojmë me diskutimet.

Kush e do fjalën?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Meqë jemi tek e njëjta temë, dua të them se më vjen mirë që për herë të parë po adresohet një problematikë, që është ngritur shumë kohë më parë në botë.

Viti i kaluar ishte viti i parë që makinat elektrike kompensuan çmimin e blerjes me atë të konsumit. Në shumë vende të botës ka pasur subvencionime. Mendoj se në aspektin e transportit publik kjo është gjë shumë e mirë. Do të doja që në të ardhmen, jo direkt subvencionim, të bëhej një studim se si mund të dekurajohej pjesa e përdorimit të makinave me karburantet fosile dhe të gjendet një mënyrë se si mund të ndikohet edhe në tregun privat të përdorimit të makinave, që t'i nxisim qytetarët, edhe për arsye ekonomike, që do ketë një moment që do të jetë shumë më përfituese të blesh një makinë të re elektrike. Pra, të shikojmë edhe ne disa masa inkurajuese drejt përdorimit të makinave elektrike dhe dekurajimit të përdorimit të mjeteve me djegie të karburanteve fosile.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Bushati!

Ka diskutime të tjera?

Urdhëroni zoti Bushaj.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Sektori i bujqësisë është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë, që nga ana e qeverisë është mbështetur, programuar dhe janë ndërmarrë një sërë reformash për ta çuar në nivelin e duhur. Së pari, për kontributin që ai jep në buxhet dhe së dyti, sepse atje punon pjesa më e madhe e qytetarëve, të cilët e kanë burimin e vetëm për t'u ushqyer.

Janë ndërmarrë një sërë masash dhe unë i vlerësoj të gjitha, por një masë tepër e rëndësishme, që do t'u shërbente të gjithë fermerëve dhe të gjithë qytetarëve tanë pa përjashtim në të katra anët e vendit do të ishte masa e heqjes së TVSH-së për inputet bujqësore. Kështu, rekomandimin e relatorit unë e quaj me vend. Do t'i propozoj komisionit, por edhe qeverisë që ta parashikojë edhe këtë masë për t'u shërbyer sa më mirë qytetarëve dhe për të ndikuar direkt te fermerët në uljen e kostos së prodhimit të produkteve bujqësore apo edhe blegtorale. Ndoshta të jetë e ndarë veç për plehrat kimike, veç për inputet, veç për farat, veç për materialet e tjera që përdoren dhe veç për simulantë të ndryshëm. Në fund të fundit, interesi ynë si deputetë dhe si qytetarë të Republikës së Shqipërisë është që këta simulantë të kenë barrë fiskale, që të përdoren sa më pak dhe ne t'i referohemi gjithmonë prodhimit Bio, që është i konkurrenshëm në treg.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Për çfarë simulantësh e kishit fjalët në bujqësi, për plehrat kimike, për pesticidet?

Xhevit Bushaj – Po.

Arben Ahmetaj – Dakord. Ka nja propozim nga Grupi Parlamentar i PS-së për të barazuar rimbursimin e fermerëve për inputet, për të krijuar një balancë të re. Do ta shohim gjatë diskutimit. Mua më vjen mirë që jeni kundër pesticideve për t'u ulur...

Xhevit Bushaj – Jo, të një përqindje e reduktuar, duke i mëshuar më tepër përdorimit të standardit edhe në bujqësi.

Arben Ahmetaj – Edhe unë bashkë me ju jam që, sa më shumë ta fenojmë përdorimin e pesticideve në bujqësi dhe të plehrave kimike, aq më shumë do të divergojmë në drejtim të produkteve Bio, por duhet të koalodojmë edhe qëndrimin fiskal. Pra, duke ulur TVSH-në, në vend që të bëjmë atë që thonë, ne i promovojmë si përdorim. Pra, praktikisht, ne rritim kërkesën nëpërmjet politikës fiskale. Ndërkohë, qëllimi nuk është të rritim kërkesën, natyrshëm që nuk duhet ta kemi, por pa dashje duke bërë një politikë fiskale të gabuar, ne promovojmë përdorimin e tyre në dëm të produkteve Bio. Gjithsesi, ne mund ta diskutojmë nen për nen. Mua më ka pëlqyer personalisht, por edhe si ministër balancimi i TVSH-së për rimbursimin e fermerëve me një politikë të kujdesshme fiskale për inputet.

Erion Braçe – Tani që të kuptohet ajo që tha zoti Bushaj. Ai foli për një ndarje të qartë midis plehrave kimike, të cilat nuk janë element i ndaluar në përdorimin bujqësor etj., dhe simulantëve që përdoren për të simuluar produktin për t'i dhënë ngjyrën, peshën etj. Zoti Bushaj kërkoi një diferencim, në rast se do të pranohet propozimi i bërë nga relatori i komisionit, midis plehrave kimike, për të cilat zoti Bushaj kërkon TVSH zero, dhe simulantëve që janë të ndaluar për t'u përdorur në bujqësi, në kuptimin e asaj bujqësie që ne duam të ndërtojmë dhe që mund të ketë një tarifë tjetër të tatimit mbi vlerën e shtuar në momentin kur hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë. Zoti Bushaj nuk po kërkon stimulimin e një bujqësie që e dëmton produktin shqiptar. Jo, nuk po kërkon këtë.

A ka diskutime të tjera?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Kur ne ndryshuam ligjin për të stimuluar investimet në sektorin e IT-së dhe në përgjithësi ishte ideja që të ndihmohej kjo industri me aparatura, me programe dhe me të gjitha. Kjo ndërhyrje do të ishte më shumë në atë logjikë, në qoftë se do të shkonte drejt asaj sesa thjesht drejt reklamave. Është një sugjerim për t'u diskutuar nen për nen. Tek aparaturat që blejnë, te sistemet që vendosin, te programet që vendosin, pra çdo gjë që ata bëjnë për *upgrade*-im se thjesht për reklamat. Reklamat janë një marrëdhënie kontraktuale biznesi midis atij që e blen reklamën, por do ta diskutojmë kur të shkojmë te neni përkatës.

Në qoftë se ne do të diskutojmë që një media do të bëjë *upgrade*, do të blejë aparatura të reja dhe do të bëjë programe të reja, kjo gjë hyn te koncepti që kemi pasur për ta stimuluar industrinë e IT-së më tepër, kur vjen puna te ndërtimi i sistemit.

Erion Braçe – A ka diskutime të tjera?

Për ta mbyllur, do të doja të rikapituloja edhe një herë propozimin që relatori i komisionit i adresoi edhe komisionit, por edhe qeverisë. Bëhet fjalë gjithnjë për tatimin mbi vlerën e shtuar për inputet bujqësore në import dhe në transaksionet e brendshme. Natyrisht, ia vlen të lavdërohet qeveria për politikën që sjell me këtë ligj, pikërisht për të aplikuar këtë skemë për të gjitha makineritë dhe pajisjet që përdoren në sektorin e bujqësisë, në funksion edhe të asaj që është afishuar në kohë të ndryshme dhe që ka të bëjë me rritjen e produktivitetit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Në krahun tjetër, unë mendoj se skema duhet të shkojë deri në fund për të gjitha inputet bujqësore. Ka 28 vjet që në këtë vend e premtojnë pa përjashtim të gjithë këtë gjë, që nga partitë që dolën menjëherë pas pluralizmit dhe hynë në parlament deri te Partia Socialiste gjatë zgjedhjeve të fundit, të vitit 2017, tani është koha që të ndërmerret kjo dhe të vendoset, me qëllim që të bëhet efektive sa më parë të jetë e mundur për të ndikuar drejtpërdrejt në kostot e punës së bujqve dhe blegtorëve në të gjithë territorin e vendit. Kështu që mendoj se kemi të gjithë kohën e mjaftueshme që, kur të diskutojmë nen për nen, ta adresojmë këtë masë, e cila, në gjykimin tim modest, si një deputet i një zone bujqësore do të ndikojë drejtpërdrejt në kostot e prodhimit, do të rrisë produktivitetin.

Po e theksoj edhe një herë se unë nuk jam bujk, por, nga ajo që dëgjoj nga ata që merren drejtpërdrejt me bujqësinë, këtu nuk bëhet fjalë për simulantët, por për plehra kimike, natyrisht edhe për pesticide, të cilat prodhohen dhe lejohen gjerësisht në BE dhe përdoren në mënyrë të qartë edhe brenda territorit të vendit, si produkte të lejuara dhe që rritin produktivitetin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Kështu që është shumë e rëndësishme për ne të ndihmojmë bujqit në gjithë territorin e vendit pikërisht me një masë të tillë që ul kostot gjatë punës së tyre.

Së dyti, e gjykoj si shumë të dobishme masën për të stimuluar produktet që vijnë nga ekonomia e gjelbër, veçanërisht në transport, por e konsideroj të pamjaftueshme incentivën me 10%. Mendoj se shkalla duhet të shkojë atje, ku praktikisht, po akomodohen një seri lehtësish fiskale, 6%, me qëllim që të krijohet një hapësirë e mjaftueshme për të stimuluar hyrjen e produkteve elektrike dhe përdorimin e tyre në transport. Shqipëria është një vend i

ndotur. Shqipëria ndotjen më të madhe të saj e ka pikërisht edhe nga përdorimi i karburanteve fosile.

Për shkak të trafikut të rënduar brenda qyteteve tona, rrugëve në rikonstrukcion, rrugëve jashtë standardit që ndikojnë në trafik, natyrisht që ndotja që vjen nga përdorimi i karburanteve fosile është shumë e madhe dhe me ndikim të jashtëzakonshëm në shëndetin e qytetarëve. Kështu që është jetike për ne që të hedhim një hap të parë, për ta shtyrë përpara të gjithë procesin e zëvendësimit të mjeteve që përdorin karburante fosile me mjete elektrike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit nëpër qytetet tona. Duhet të jetë një politikë shumë e mirë dhe mendoj që edhe këtë ta shikojmë kur të vijmë në diskutimin nen për nen.

Së fundi, natyrisht, nuk e kisha me të qeshur çështjen e librit. Sot që flasim, prej vitit 2006, libri ka një handikap shumë të madh. TVSH-ja për të është 20% në blerje dhe zero në shitje, duke krijuar një problem, të cilin ata janë munduar ta adresojnë në vijimësi me letra, drejtuar ministres përgjegjëse, natyrisht edhe komisioneve përgjegjëse të Kuvendit. Kësaj radhe kanë ardhur në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Kështu që do të ishte mirë të shikohej edhe kjo pikë. Ata nuk kërkojnë TVSH zero, ata po kërkojnë një TVSH të barabartë, me qëllim që të mos u krijohet kosto gjatë aplikimit të kësaj mase në aktivitetin e tyre të botimit dhe të tregtimit të librave.

Urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Për sa i përket politikës së gjelbër, jam dakord me ju, që ne kemi avancuar si qeveri dhe faleminderit që e mbështesni!

Besoj se duhet të jetë e kujdesshme dhe graduale për të parë efektet dhe për të mos koroduar bazën fiskale.

Për sa u përket imputeve bujqësore, mua më ka pëlqyer shumë propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste në mbledhjen e fundit për balancimin e nivelit të TVSH-së dhe imputeve me rimbursimin për fermerët, pra me kënaqësi e mbështeta për atë që më takon dhe atë që mundem. Kështu që kur ta diskutojmë nen për nen, sigurisht, do të jemi bashkë për të balancuar inputet me përqindjen e TVSH-së që rimbursin fermerët. Besoj se bëjmë një balancë të shëndetshme, në funksion të promovimit të bujqësisë dhe në të njëjtën kohë të konsolidimit fiskal, por edhe të një transparence më të thellë të skemës së rimbursimeve.

Erion Braçe – Pa asnjë lloj diskutimi mbetemi në këtë çështje. Unë nuk arrij ta kuptoj se çfarë do të thotë balancim në këtë pikë?! Megjithatë mbetet për t'u sqaruar në momentin që do të vijmë te diskutimi nen për nen. Në qoftë se e keni fjalën për skemën e rimbursimit me 20% në vlerë të çdo leku në shitje të produkteve bujqësore dhe blegtorale,

me gjithë përpjekjen tuaj maksimale, nuk e diskutoj këtë pjesë të ministrisë repsektive, tonën këtu e të tjerë me radhë, ajo skenë nuk ekziston për të çuar te bujku paratë që ne si qeveri, ne si Parti Socialiste, kemi menduar që, përmes kësaj politike, ta adresojmë. Nuk funksionon. Ajo skemë po çon para te grumbulluesit dhe ju jeni dëshmitar, kemi qenë bashkërisht në krahët e njëri-tjetrit kur njerëzit ju kanë treguar faturat që grumbulluesit presin, që nuk alokojnë te bujqit pikërisht këtë vlerë rimbursimi dhe praktikisht qeveria po ua rimbursion grumbulluesve. Kjo është e vërteta. Se çfarë do të thotë balancim në këtë pjesë, e shikojmë në momentin që do ta diskutojmë nen për nen, por e vërteta për këtë skemë është kjo.

Arben Ahmetaj - Që të përgatitemi në vazhdimësi, jam dakord me ju që skema ka probleme transparence, me gjithë përpjekjet e mëdha të të gjitha organeve fiskale. Balancimit i referohem, në qoftë se do ta çojmë domosdoshmërisht në këto nivele, që do të çojmë inputet me TVSH të reduktuar nga 20% në 10% balancimit i referohet rimbursimit nga 20% në 10%, në qoftë se do ta çojmë nga 20% në 6% rimbursimin.

Më vjen mirë që jemi në të njëjtin harmoni mendimi, që në njërin korsi do të mundohemi të përmirësojmë produktivitetin në bujqësi, nga ana tjetër, do të reduktojmë më një instrument tjetër, mundësinë e abuzimit të një skeme, e cila ishte dedikuar për të ndihmuar fermerin. Kjo na krijon të dyja hapësirat, në kahun e të ardhurave humbin X, dhe do ta diskutojmë kur të jemi nen për nen, në krahun e shpenzime përfitojnë, duke ulur abuzimin dhe duke u kthyer te një logjikë, ndoshta më e balancuar, prandaj e ilustrua. Pastaj kuptohet që do të na ngelet në vazhdimësi që ta monitorojmë me kujdes politikën e uljes së TVSH-së për inputet që domosdoshmërisht lista e inputeve duhet të behet me të njëjtën një filozofi që kemi bërë të gjithë listën e makinerive dhe pajisjeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Nuk kam asgjë kundër kujdesit në trajtimin e kësaj çështjeje dhe çështjeve që lidhen drejtpërdrejtë me shpenzimet dhe me të ardhurat, relacionit që krijohet midis tyre për shkak të kësaj mase e të tjera me radhë. Por më lejoni t'ju them se nuk mendoj si ju. Mendoj se buxheti i shtetit nuk do të ketë asnjë humbje nga aplikimi ose bërja faktike e propozimit që u bë këtu nga kolegët deputetë, përkundrazi bujqësia do të përfitojë jashtë mase.

Së pari, ajo që do të marrë goditje është kontrabanda e inputeve bujqësore, duke filluar nga plehrat kimike. Janë krijuar gropa të thella në të gjithë sistemin fiskal për shkak të kontrabandës dhe kontrabanda ka dëmtuar në mënyrë të qartë, cilësinë e plehrave kimike,

farave, fidanëve dhe çdo gjë tjetër. Kështu që, në momentin më të parë marrja e kësaj mase do të godasë dhe do të bëjë të padobishme kontrabandën, do të ndihmojë jashtë mase atë që fermerët dhe bujqit sot e kanë shqetësim shumë të madh, që e blejnë dy herë, një herë me çmimin e shtrenjtë dhe më pas e blejnë me cilësinë mizerabël që kanë këto produkte për shkak të kontrabandës dhe, natyrisht, do të rrisë produktivitetin në bujqësi. Kështu që unë nuk mendoj se do të ketë një humbje buxhetore, megjithatë këtu jemi, le t'i bëjmë llogaritë një për një në momentin që do të hyjmë në diskutimin nen për nen të projektligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Këtu e mbyllim diskutimin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”;

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Kalojmë te projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”.

Fjalën e ka zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Për sa u përket tarifave doganore do të flas shkurt. Është një propozim që ka ardhur nga administrata doganore për sa u përket disa kodeve 8-shifrore 8418. Praktikisht është një masë antievazion, duke iu referuar diferencës së vlerës brenda kategorisë 8418. Pra, po unifikojmë tarifën doganore në masën 10% për të gjithë kategorinë . Kaq është thelbi i këtij ndryshimi për tarifatat doganore.

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Në nenin 1 të këtij projektligji propozohet një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”. Konkretisht, propozohet rritja e nivelit të tarifës doganore nga 2% në 10% për katër kodet e të kreut 8418 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, që përfaqësojnë ftohës ngrirës të kombinuar, të përshtatur me dyer të jashtme të veçanta me kapacitet mbi 340 litra dhe të tjerë, si dhe ftohës ngrirës të kombinuar të përshtatur me dyer të jashtme me kapacitet deri në 400 litra, si dhe kapacitet mbi 4 mijë litra, por deri në 800 litra. Sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave, në kreun 8418 në nivel 8 shifror përfshihen 20 kode tarifore, nga të cilat 4 prej tyre kanë tarifën doganore 2%, ndërsa kodet e tjera kanë tarifën doganore 10%. Nga të dhënat statistikore rezulton se ky artikull, njësi frigoriferike prodhohet dhe ka origjinë nga vende të ndryshme kryesisht Kinë- Rumani- Poloni e të tjera, 77% e tyre janë zhdoganuar në kodet tarifore respektive me tarifë doganore 2% dhe vetëm pjesa e mbetur është zhdoganuar me 10%. Me qëllim që të mos lejohet që operatorët ekonomikë, në mënyrë të qëllimshme, të bëjnë klasifikim tarifor të këtyre produkteve drejt kodeve tarifore me tarifë më të ulët, pra duke iu shmangur kështu produkteve me tarifë doganore më të ulët, duke iu shmangur kështu nivelit të taksës doganore 10%, që është fasha e dytë më e lartë, ky projektligj propozon një fitim të tarifës doganore në masën 10% për të gjitha kodet 8 shifrore të kreut 84/18 për njësitë frigoriferike, të nomenklaturës së kombinuar të mallrave. Unifikimi i tarifës vlerësohet të sjellë një efekt pozitiv, pra një rritje në masën plus 50 milionë lekë.

Erion Braçe- Kalojmë te pyetjet.

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi- Zoti Ministër, personalisht besoj se është një masë e duhur unifikimi i tarifave dhe do të jem gjithmonë pro kësaj lloj lëvizjeje, por unë doja të dija kur është bërë ky shkallëzim dhe pse. Në përgjithësi, shkallëzimet kanë stimuluar një gjë, pra të ndihmojnë në diçka. Pse është bërë ky ndryshim i këtyre 4 kodeve dikur me 2%?

Arben Ahmetaj – Thelbi i skanimit të detajuar në doganë sa i përket nënkodeve brenda një kategorie ka të bëjë me 11- shifrorin që ne ende nuk e kemi të aplikuar në doganë. Ne jemi në 8-shifror dhe kjo na pengon të shkojmë më tej në praktikën dokumentare, por edhe në praktikën e skanimit, sepse ka sipërmarrje që e shfrytëzojnë pamundësinë e administratës për të kaluar në 11 shifror që ka të bëjë me detajimin në kuptimin pozitiv të fjalës “ekstrem” të natyrës, të profilit dhe të vlerës së mallit. Për këtë arsye ne shkojmë në unifikim dhe besojmë se do të kemi një skanim më të mirë dhe nuk do të lejojmë diferencime, të cilat godasin vlerën në mënyrë jo reale.

Erion Braçe- Doja të plotësoja pyetjen që bëri zoti Pëllumbi, sepse nuk arrita ta kuptoj pse është vendosur tarifa 2% për këto 4 kode.

Arben Ahmetaj – Ka qenë shumë e hershme, por praktika doganore në bazë të asaj që ka kërkuar dogana ka treguar që ka krijuar vështirësi serioze.

Erion Braçe- Unë do të doja të dija pse është vendosur 2% dhe pastaj 10% në kodet e tjera?

Arben Ahmetaj – Ka qenë që nga koha kur i vendosi MSA-ja, për shkak të diferencimit të origjinave dhe të profileve të mallrave, gjë që praktikisht ka krijuar atë gep që dogana na e njofton dhe ne i rikthehemi unifikimit.

Erion Braçe- Tani ne nuk kemi detyrime ndaj MSA-së?

Arben Ahmetaj – Kemi.

Erion Braçe – Mos po shkelim MAS-në me këtë?

Arben Ahmetaj - Jo.

Erion Braçe –Pse nuk e shkelim?

Arben Ahmetaj – Nuk e shkelim sepse po unifikojmë, nuk po bëjmë diferencime. Diferencimi ishte pjesë e angazhimit unilateral, nuk ishte pjesë e angazhimit multilateral.

Erion Braçe- Nuk e mendoj kështu. Domethënë, në ligjin nr. 9590, datë 27.03.2006 për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në kapitullin e tretë, nenet 32, 33, pika 1 thuhet: “Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet palëve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe këtu ose në protokollet 1,2,3. Në nenin 33 “Pezullimi” thuhet: “Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje nuk

vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to dhe nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet komunitetit dhe Shqipërisë”. Praktikisht, përtej asaj që thatë ju, rregullimit të kodeve, ne po rrisim tarifën nga 2% në 10% për këto 4 kode. Ky është problemi.

Arben Ahmetaj- Jeni duke folur për mallrat e origjinave të ndryshme. Unifikimi nuk sjell diferencim. Nuk është se ne kemi rritur tarifa të tjera doganore. Kjo nuk është hera e parë që ne bëjmë një përdorim të tarifës si instrument. Kështu që nuk shoh asnjë shqetësim për sa i përket MSA-së.

Erion Braçe- Asnjë shqetësim?

Arben Ahmetaj- Jo.

Erion Braçe- Unë nuk e pranoj këtë logjikë në momentin që dogana ka vështirësi të bëjë detyrën. Ky është problemi. Nëse dogana ka vështirësi të bëjë detyrën, dogana të kthehet të bëjë detyrën normalisht, jo të prishim një politikë të vendosur këtu dhe që, natyrisht, buron nga dokumente që ne i kemi angazhime me Bashkimin Europian ose me komunitetet, siç thuhet. Nga relacioni kuptoj që, pavarësisht se pjesa më e madhe e produkteve frigoriferike vijnë nga Kina, Polonia, Rumania, të gjitha, 77%, zhdoganohen me 4 kode që kanë tarifën 2% dhe që i referohet kësaj marrëveshjeje që ne kemi me Komunitetin Europian. Pra, kjo është një çështje administrimi dhe çështjet e administrimit rregullohen duke përmirësuar shërbimin dhe administrimin në doganë, nuk rregullohen duke bërë këtë gjë, sepse unë mendoj se këtu po diktohet apo po ndikohet drejtpërdrejt në biznesin e këtyre njerëzve që merren me këtë punë. Për të luftuar pjesën e abuzimit, mblidh produkte dhe futi në këto 4 kode, kjo po, ju jap të drejtë, puna në doganë të shumëfishohet me qëllim që të mos lejohet asnjë lloj shpërdorimi i kësaj politike në këto nivele. Po të shkojmë te rritja e tarifës thjesht për nevojë të administrimit, i bie pak si shtrenjtë.

Arben Ahmetaj- Unë mendoj se kam nevojë t’jua shpjegoj sërish që nuk po bëjmë diferencim për të ndihmuar bizneset, po unifikojmë tarifa dhe 50 % e këtyre mallrave vijnë nga Kina. Ne po mbylлим një mundësi evazioni.

Erion Braçe- Po e keni edhe sot këtë mundësi.

Arben Ahmetaj- Kështu e shoh unë, prandaj kam pranuar logjikën e administratës doganore të unifikimit të tarifës.

Erion Braçe- Zoti Ministër, së pari, duhet t’i themi administratës doganore që produktet që vijnë nga Kina t’i akomodojë në kodet që janë respektivisht për këtë gjë. Unë mendoj se këtë duhet t’i themi administratës doganore me qëllim që ajo të mos marrë

produkte nga Kina dhe t'i akomodojë atje ku ka interes të bëjë këto favore. Kjo është e para, pastaj mund t'i pranojmë çdo lloj kërkesë, po kështu i bie që ne të prishim çdo lloj politike për shkak të nevojave të administrimit në institucionet tona fiskale.

Arben Ahmetaj - Kryetar, akomodimi në kode...

Erion Braçe- Do të vijmë në një pikë tjetër, te një ligj tjetër dhe do të hasim prapë të njëjtën logjikë. Për nevoja të administrimit e bëjmë këtë gjë, por natyrisht dëmtojmë.

Arben Ahmetaj – Kryetar, akomodimi në kode nuk është artificial.

Erion Braçe- Nga relacioni thuhet që është abuziv, jo artificial.

Arben Ahmetaj - Nuk akomodohen artificialisht në kode, janë arsye xhenerike.

Erion Braçe- Duke iu referuar doganës, ju këtë sillni si argument, abuzimin, dhe, në vend që të akomodohen me tarifën 10%, po i çon te 2%- shi po me abuzim, thoni ju në relacion.

Arben Ahmetaj – Jo, dhe nuk ka të bëjë me administratën doganore që po abuzon, ka të bëjë me sipërmarrjen që luan me të dyja tarifat.

Erion Braçe- Po, të mos e lejojmë sipërmarrjen të luajë me të dyja.

Arben Ahmetaj – Sepse nuk jemi në nivelin...

Erion Braçe – Administrimin e kemi ne, zoti Ministër. Çfarë është kjo sipërmarrje që udhëheqë administrimin? Administrimi është publik dhe i shtetit, mbaron këtu historia. Sipërmarrja duhet të mësohet, me të gjithë favorët që ne i kemi bërë gjatë gjithë kësaj periudhe, duhet të kuptojë që në këtë vend nuk bëhet biznes pa paguar asgjë dhe, nëse do që të bëjë biznes, atëherë duhet të paguajë të gjitha detyrimet shtetërore.

Arben Ahmetaj – Ma ndërpreve.

Erion Braçe – Ju kërkoj ndjesë.

Arben Ahmetaj – Nuk ka gjë. 70 mijë dhe 20 mijë është raporti mes dy përqindëshit. Pra, ka devijuar te dy përqindëshi dhe kjo jo për shkak...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'e besoj që do të më kërkosht ndjesë përsëri, sepse do të më vësh në siklet.

Erion Braçe – Ju kërkoj ndjesë përsëri, që të mos viheni në siklet.

Arben Ahmetaj – Mos më kërkon fare.

Erion Braçe – Për ta mbyllur, që të mos kërkoj më ndjesë, ju në relacion thoni se ka përfunduar në këtë pikë për shkak të abuzimit.

Arben Ahmetaj – Dakord, po ma ndiq logjikën. Pra, sipërmarrja tenton dhe kjo nuk është një betejë e ditëve të sotme, por është një betejë e pafundme që sipërmarrja bën për t'u shmangur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aman mos më kërko më të falur.

Erion Braçe – Jo, sinqerisht është turp që po diskutojmë për frigoriferët. M'u bë kohë e gjatë këtu dhe kjo çështja e frigoriferëve është kthyer njësoj si çështja e tapave të shishes së birrës, që sa herë bëhej paketa fiskale, një herë vinte etiketa, një herë tapa dhe një herë kjo dhe ajo.

Arben Ahmetaj – Ke shumë të drejtë, prandaj po e unifikojmë që të mos ketë më për tapa dhe për shishen. E gjithë logjika e unifikimit është që të gjitha mallrat të 90 mijë njësive të tarifohen njëloj, ky është i gjithë diskutimi. Unë, ti dhe komisioni nuk jemi marrë as me tapën dhe as me shishen, ne jemi marrë me standardizime.

Erion Braçe – Ne i kemi dëgjuar, se kur bëhej kjo punë ishim në opozitë. Një gjë nuk kuptoj, përse nuk bëhet nga 10 në 2, por bëhet nga 2 në 10?

Arben Ahmetaj – Nuk duam të humbasim të ardhurat.

Erion Braçe – Si nuk doni të humbisni të ardhurat, kur ju thoni që 70% të mallrave po zhdoganohen me 2%?

Arben Ahmetaj – Këtë po bëjmë pra.

Erion Braçe – Po pse e bëni 2%?

Arben Ahmetaj – Jo 70%, por 70 mijë e 300 njësi.

Erion Braçe – Zoti Ministër, a t'ju bëj një pyetje më të thjeshtë, këto produkte që vijnë me katër kode, me çfarë vlere fature vijnë, me vlerë të lartë apo të ulët?

Arben Ahmetaj – Varet, por më të ulët.

Erion Braçe – Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Unë u kam kërkuar tatimeve dhe doganës që të bëjnë një investigim për një dosje dhe më besoni që mallrat vinin me gjysmën e çmimit. Këtë dosje e kam ndjekur për një vit rresht, për një mall me të njëjtën logjikë. Futeshin nga Bullgaria në një zonë të lirë ekonomike në Serbi me 300 dollarë dhe i njëjti mall, me të njëjtin kod, me të njëjtin profil dhe nga i njëjti operator dilte nga zona ekonomike me 150 dollarë. Në Republikën e Shqipërisë vinte me 150 dollarë, sepse ishte filtruar në zonën ekonomike me gjysmën e vlerës. Një vit i kam qëndruar në kokë administratës së doganës dhe të tatimeve në tagrin si ministër i Financave për ta parë si fenomen. Ky është një fenomen jo i rrallë, por po

luftohet. Prandaj mendoj që unifikimi na ndihmon dhe nuk cenon të ardhurat, përkundrazi. Edhe për atë që thatë ju për t'u mos u marrë me shishen veç dhe me tapën, veç po e bëjmë unifikimin.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Nuk po e zgjas më, sepse këtu futen produkte me 60 euro, por po e lë këtë pjesë.

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Në fakt, ju adresoni një problem që është shumë i drejtë dhe unifikimi nuk lë vend as për evazion dhe as për konkurrencë të pandershme, por në dy rastet duhet jemi në rregull me OBT-në dhe me MSA-në. Kur shkohet drejt unifikimit, është e përcaktuar të jetë më e ulët se 5%, siç e ka OBT-ja, por, nëse mund ta bëjmë 10 dhe nuk ka pengesa ligjore, unë jam dakord.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Mbyllim këtu edhe diskutimin e ligjit “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore.”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012 ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Kalojmë te projektligji tjetër i paketës fiskale “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Arben Ahmetaj – Për sa u përket akcizave, ne kemi sjellë ndryshime të nivelit të akcizës për produktet e duhanit të grirë, purot, cigarillot dhe cigaret me zëvendësues duhani, nga 4400 lekë kilogrami, në 6000 lekë kilogrami.

Shtimi i një produkti të ri, duhani me ngrohje, në listën e mallrave të akcizës në masën 6 mijë lekë kilogrami.

Heqja nga lista e mallrave të akcizës për fishekzjarrët, llambat, pilat, bateritë dhe rërat bituminoze. Vendosja e akcizës për rërat bituminoze ka qenë një lapsus që e kemi bërë përpara një viti, ku produkti rëndomtë ka filluar të përdoret si lëndë djegëse zëvendësuese për shumë industri.

Saktësimi i metodës së përlllogaritjes së akcizës për produktin nikotinë lëng, për mbushjen e cigareve elektronike, që të mos kishim asnjë konfuzion. Ndryshime në kreun e shkeljeve për fushën e akcizës dhe sanksioneve.

Këto janë pak a shumë ndryshimet që kemi sjellë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Përmes këtij projektligji propozohen disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr, 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, përmes të cilit përcaktohen rregullat e përgjithshme për prodhimin, mbajtjen, magazinimin, lëvizjen dhe kontrollin e produkteve që u nënshtrohen detyrimeve të akcizës, si dhe të vendosë rregulla specifike për akcizën që zbatohet për konsumin e produkteve energjetike, alkoolin, pijeve alkoolike, duhanin dhe nënproduktet e tij.

Në nenin 1 projektligji parashikon saktësimin e mënyrës së aplikimit të pullave fiskale për duhanin e grirë, duke përcaktuar vendosjen e pullave të akcizës poshtë qeses së ambalazhit për çështje sigurie dhe jo se si ka qenë e vendosur deri më sot mbi qesen.

Në nenin 2 parashikohet shtimi në listën e duhanit e nënprodukteve të tij dhe të kodit 24039090 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, që i përket duhanit me ngrohje dhe që është një produkt i ri që i shtohet listës së produkteve, që paguajnë akcizë për shkak të specifikave të tij.

Në nenin 3 dhe 6 të projektligjit shtohen të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë procesit të porositjes, prodhimit dhe lëvizjes së tyre, si dhe përcaktohet masa e penaliteteve në rastin e tepricave ose mangësive të konstatuara në porositje, prodhim dhe lëvizjen e pullave të akcizës.

Në nenet 4 dhe 7 të projektligjit parashikohet ndryshimi i mënyrës së përlllogaritjes së penaliteteve në nenet 88 dhe 95 të ligjit bazë, duke marrë për bazë në përlllogaritjen e penaltetit vetëm detyrimin e akcizës dhe jo detyrimet fiskale në tërësi për produktin, duke sjellë një ulje të masës së penaltetit vetëm për akcizën.

Në nenin 5 të projektligjit bëhet një ndryshim në nenin 90, pika 6, shkronja ç e ligjit bazë, ku trajton tepricat ose mangësitë në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës, duke hequr si shkelje konceptin e tentativës për të shmangur produktin nga pagesa e akcizës.

Projektligji sjell gjithashtu edhe ndryshimin në shtojcën 1, pjesë e ligjit bazë që përfaqëson listën e mallrave të tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë si më poshtë:

Heqjen nga lista e mallrave të akcizës së artikujve, si: fishekzjarrë, llamba dhe pila ose bateri në nivel të akcizës respektivisht në masën 200 lekë kilogramin dhe 100 lekë copa. Së pari, ky ndryshim bëhet bazuar në direktivën e Komitetit Europian nr. 118/2008, sepse këto produkte nuk konsiderohen si produkte akcize.

Së dyti, për këto produkte ligji për akcizën nuk parashikon ndonjë procedurë specifike për mbikëqyrje të tillë, si detyrimi për t'u mbajtur në një magazinë fiskale, apo që operatori ekonomik dhe pajisja me një status specifik të tillë, si ai i depozituesit të miratuar apo prijësit të regjistruar.

2. Ndryshohet niveli i akcizës për produktet e duhanit të grire, si puro, cigarilos dhe për cigaret me zëvendësues duhani nga 4400 lekë kilogrami në masën 6000 lekë kilogrami. Ndryshimi ka qëllim barazimin e nivelit të taksimit të produkteve të kësaj kategorie në kategorinë cigare, që përmbajnë duhan, duke e çuar nivelin e akcizës në masë të njëjtë me kalendarin e taksimit të cigareve me 1 janar 2019. Ky unifikim çon, gjithashtu, drejt përafrimit të mëtejshëm me direktivën e BE-së 64/2011, e cila përcakton për këto produkte nivelin minimal të akcizës të paktën 60 euro për kilogram. Gjithashtu, lidhur me duhanin e përpunuar, vijon politika mbështetëse për prodhimin vendas e vendosur në vitin 2016, duke përcaktuar nivel akcize në masën 2500 kilogrami për duhanin e prodhuar brenda vendit, me gjethe të duhanit nga bimë të kultivuara në Shqipëri, ndërsa po i njëjti produkt i importuar është parashikuar ta ketë akcizën në masën 6000 mijë lekë për kilogram, kur është i hapur.

3. Në kategorinë e produkteve të duhanit shtohet një produkt i ri “duhan me ngrohje”, që është një produkt njësoj si cigarja, por që konsumohet nëpërmjet një aparati të prodhuar posaçërisht për të, e diferencuar sipas firmave. Ky produkt klasifikohet në kodin 2403 9090 të kreut 2403 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, aty ku përfshihet duhani tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit të homogjenizuar apo i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca duhani. Për këtë arsye edhe për këtë produkt niveli i akcizës propozohet në masën 6000 lekë për kilogram, pra unifikohet.

4. Propozohet heqja nga lista e produkteve të akcize i rërës bituminoze, e cila aktualisht është në akcizë në masën 2 lekë për kilogram, pasi vlerësohet se ajo nuk mund të përdoret si lëndë djegëse. Ndërkohë, propozohet shtimi si produkt akcize i zhavorrit bituminoz për shkak të përdorimit të tij madh kohët e fundit si lëndë djegëse zëvendësuese në industrinë e prodhimit të çimentos, tullave etj., siç tha edhe ministri.

5. Projektligji propozon edhe saktësimin e metodës së përllogaritjes së akcizës për produktin nikotinë lëndë që shërben për mbushjen e cigareve elektronike, duke taksuar vetëm produktin e zhveshur nga ambalazhi.

Ndryshimet e propozuara kanë një efekt pozitiv në buxhetin e shtetit në masën 144 milionë lekë plus, për sa më sipër, duke vlerësuar se ndryshimet e propozuara mundësojnë përmirësimin e administrimit të pullave të akcizës në të gjithë fokusin e veprimtarisë së tyre, unifikimin dhe krijimin e kushteve të njëjta për të gjithë operatorët e akcizës, i propozoj komisionit miratimin në parim të këtij projektligji.

Faleminderit!

Erion Braçe – Kush ka pyetje?

Ervin Bushati – Kam unë disa pyetje.

E kuptoj që masa që merret për cigaren është një masë shumë e mirë, e kam më shumë për këtë me ngrohje, sipas studimeve, është një masë shume mirë...

Erion Braçe – Pyetjen...

Ervin Bushati – Do ta them. Pra, sipas studimeve, del që dëmtojnë më pak dhe mund të ketë mundësi që të stimulohen në vend, të dyja janë për t'u demotivuar, por, me ç'kam parë, këto janë më të vogla në volum, por janë përsëri me fije. Këtu propozohet që ndryshimi i akcizës të jetë me kilogram. Pse të mos jetë me fije tek ato që janë me fije? Unë nuk e pi cigaren, por, me sa kuptoj, e një pjesë më e vogël, që është sa e një e treta, do të zëvendësojë një cigare, atëherë pse të mos jetë me fije, sepse ka më shumë efekt në buxhetin e shtetit, por me kilogram? Pra, është e njëjta paketë, pra akciza do t'i merret në vlerë sa e një

e treta, nëse bëhet me peshë. Gjithsesi, nuk jam shumë teknik te kjo pjesë dhe nuk ia kam shumë idenë, por ato janë fije për fije.

Arben Ahmetaj – Ka dy elemente. I pari është që, praktikisht, duke qenë se është duhan me ngrohje dhe nuk është fije, pra në referencë teknike tradicionale, duke parë edhe se si e trajtojnë në BE, pra me kilogram, edhe ne kemi ruajtur një nivel rreth 70% të mënyrës. Gjithsesi, kur ta diskutojmë nen për nen, do t’ju sjellim një përlllogaritje se çfarë do të thotë me fije, por që nuk është definicioni tradicional dhe çfarë do të thotë me kilogram dhe do ta gjykojmë.

Ervin Bushati – Unë e kam parë...

Erion Braçe – E diskutojmë nen për nen.

Ervin Bushati – Dakord, po kaloj te pika tjetër, te masat që keni vënë për fishekzjarrë, llamba, pilat dhe bateritë kam një pyetje: pse fishekzjarrët?

Tjetra, ndoshta e shohim kur ta diskutojmë nen për nen ose me masa të tjera, para pak muajsh BE-ja ka kaluar masën që demotivon përdorimin e inkandeshenteve, halogjenëve të tjerë dhe ka futur vetëm llambat led. Mos ndoshta ka ardhur koha që edhe në të fillojmë ta futim si koncept, sepse konsumojnë shumë më pak. Të futet që tani koncepti i ledit dhe të ndalojmë përdorimin e llambave të tjera. Ndoshta është pak e avancuar, por...

Arben Ahmetaj – Për ta kuptuar qartë: ju po propozoni që, përtej kategorisë së ledit, të përdorim instrumente fiskale demotivuese? Ky ishte propozimi juaj?

Ervin Bushati – Sot në Europë para një muaji më duket, lejohet të tregtohen vetëm llamba led dhe asnjë gjë tjetër. Dua të di nëse bëhet, se nuk duan të hyj të detajet.

Arben Ahmetaj – Çdo gjë racionale, që nuk është shpikje, por praktikë e mirë ndërkombëtare nuk kemi pse të mos e bëjmë. Kjo është një kërkesë e FMN-së edhe në logjikën që këto nuk janë mallra të akcizueshme. Praktikisht, ne i kemi futur në akcizë, por ato nuk janë mallra të akcizueshme. Në fakt, FMN-ja e ka kërkuar vazhdimisht, por në gradualitetin tonë të konsolidimi fiskal, gjithsesi efektet janë të vogla. Tani për të trajtuar atë element që ju thatë, duhet ta trajtojmë komplet më vete edhe nga ana e teknikës ligjore, edhe nga e teknikës fiskale.

Ervin Bushati – Jam shumë dakord me motivimin brenda demotivimit të industrisë së duhanit që është e dëmshme, por që prodhimi vendas i grirë të jetë 2500 lekë për kilogram, kurse i huaji të jetë 6000 mos biem ndesh më MSA-në?

Arben Ahmetaj – Jemi plotësisht në logjikë dhe duhani vendas nuk preket, mbetet 2500 dhe nuk asnjë problem me MSA-në edhe për shkak të produktit që tregtohet ndryshe.

Erion Braçe – Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, Kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Kam një pyetje për më shumë sqarime për sa i përket propozimit për të hequr akcizën nga zhavorri bituminoz dhe nga rëra bituminoze. Te relacioni që keni sjellë thuhet se rëra bituminoze nuk mund të përdoret si lëndë djegëse, pasi përmbajtja e bitumit është 6%-9%. Thuhet, gjithashtu, se e ka çmimin tri herë më të ulët. Ndërkohë, sa është niveli i bitumit te zhavorri bituminoz? E di që është teknike, nëse mundeni, për të qenë më të qartë për këtë.

Arben Ahmetaj – Patjetër, pyetja është shumë e drejtë dhe shumë e goditur. Rërat bituminoze...

Blerina Gjylameti – Të falënderoj për vlerësimin!

Arben Ahmetaj – Rërat bituminoze e kanë nivelin e djegshmërisë për shkak të nivelit të bitumit joekzistent, dhe ka qenë një lapsus kur e kemi vendosur, ndërsa zhavorri bituminoz, e ka djegshmërinë shumë të lartë, sepse është kthyer në lëndë djegëse në paktën dy industri. Për shembull në furrat e çimentos 90 mijë tonë, gradualisht duke u rritur, përsëri ka zëvendësuar karburantet, gazin, kështu që patjetër që e ka djegshmërinë, bitumin mbi 50%. Po ta them zyrtarisht nuk ka pikë rëndësie se sa e ka nivelin e bitumit, përderisa zëvendëson një lëndë djegëse. Gjithsesi, në aspektin fiskal, në momentin kur zëvendëson një lëndë djegëse si lëndë djegëse, bëhet e akcizueshme. Ky është parimi fiskal. Parimin teknik se sa e kanë djegshmërinë, patjetër që nga kurioziteti e ndava me ju, por në aspektin fiskal ditën kur bëhet lëndë djegëse akcizohet.

Blerina Gjylameti – Kam edhe një pyetje tjetër përsëri për këtë gjë. Meqenëse ka një nivel shumë të lartë të karbonit, po ashtu edhe të squfurit, a mos ndoshta duhet të kemi një nivel më të lartë të akcizës, meqenëse kemi edhe disa politika për mbrojtjen e mjedisit?

Arben Ahmetaj – E drejtë edhe kjo, si e para. Ta diskutojmë nen për nen dhe të gjejmë diçka racionale, në qoftë se niveli i ndotjes është shumë i lartë.

Faleminderit që na e sollët në vëmendje!

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Roland Xhelili – Kryetar, jam dakord pjesërisht me problemin, siç e ngriti zonja Gjylameti. Në relacionin që ju keni sjellë për projektligjin ju thoni se produkti zhavorri bituminoz i nënshtrohet pagesës së akcizës në të njëjtin nivel me produktin që zëvendëson, kur përdoret si zëvendësues i një lënde djegëse. Aktualisht, për ato firma apo shoqëri minerare që merren me prodhimin e tyre do të vendoset akciza për prodhim, apo kjo ka

lidhje vetëm me rastin kur përdoret si lëndë djegëse? Në këtë rast më duket sikur ka një lloj kundërshtie dhe dëmtohen shoqëritë minerare që merren me prodhimin e tyre.

A është bërë ndonjë llogari, apo jo? Edhe te relacioni që shoqëron vendimin për buxhetin thuhet 2 lekë për kilogram, kurse në projektligj vjen 1 lekë për kilogram. Mos është diçka e shpejtuar dhe e pa llogaritur siç duhet. A ndikon kjo te shoqëritë minerare? Ato pak shoqëri, që merren me prodhimin e tyre, a mund të vazhdojnë të punojnë, apo rrezikojnë mbylljen?

Arben Ahmetaj – Praktikisht, i gjithë prodhimi i zhavorrit bituminoz shkon në furrë.

Erion Braçe – Nuk pyeti për këtë zotëria.

Arben Ahmetaj – Kam përshtypjen se për atë pyeti, ndoshta nuk e kam kuptuar.

Erion Braçe – Zotëria iu referua ligjit, i cili thotë se në rast se keni një lëndë zëvendësuese, norma e akcizës për të duhet të jetë e barabartë me normën e akcizës për lëndën tjetër.

Arben Ahmetaj – Pyeti për të dyja. Do të flas edhe për atë.

Pyetja e pare, nëse e kuptova unë, ishte: pse nuk është bërë akciza në nivelin e të gjitha lëndëve të tjera djegëse?

Pyetja e dytë ishte: i gjithë prodhimi, apo vetëm ai që shkon në furrë

Roland Xhelili – Ndikimi që ka te shoqëritë që merren me këtë prodhim.

Arben Ahmetaj – Po ta shikoni nivelin e taksës, në qoftë se çmimi shkon 2800 lekë, ne e kemi vënë akcizën 1000 lekë; kemi ruajtur logjikën, pra merakun sesa do të dëmtohet industria. Bëmë një diskutim të detajuar dhe të kujdesshëm me Ministrinë e Infrastrukturës për vendosjen e akcizës, në mënyrë që të mos bëheshim iracionalë në ngarkesën fiskale. Sigurisht, jemi duke folur për zhavorrin bituminoz kur përdoret si lëndë djegëse, por i gjithi përdoret si lëndë djegëse.

Roland Xhelili – Për merak dua të theksoj se nga një informacion që kam, ka një histori të akcizave te këto shoqëritë minerare që jo gjithmonë kanë dhënë rezultate pozitive, madje jeni detyruar që herë pas here t'i shikoni, t'i hiqni dhe t'i rivini. Mendoj se kishte nevojë të analizohej më me kujdes.

Erion Braçe – Për ta sqaruar deri në fund, kam disa pyetje zoti Ministër: cilën lëndë djegëse zëvendëson koksi?

Arben Ahmetaj – Besoj se e dini që furrat e industrisë në përgjithësi djegin nënproduktet e rënda.

Erion Braçe – Cilat janë?

Arben Ahmetaj – Koks, por ka raste edhe naftë bruto.

Erion Braçe – Këto prodhohen në vend?

Arben Ahmetaj – Po, prodhohen ose importohen.

Erion Braçe – Sa për qind të lëndëve djegëse zëvendësojnë këto?

Arben Ahmetaj – Ne sapo e kemi vëzhguar si fenomen në terrenin ekonomik, janë rreth 90 mijë tonë të përdorura në 7 muaj, sepse atëherë filluam të koncentroheshim te ky fenomen në terrenin ekonomik.

Erion Braçe – Sa për qind të lëndëve djegëse të 90-mijëtonëshit?

Arben Ahmetaj – 600 mijë importohen, ku 60-70 mijë tonë përdoren si lëndë djegëse, të cilat janë naftë e rëndë bituminoze, pra bruto bituminoze. Nuk është puna te përqindja, zoti kryetar, por te devijimi i bazës fiskale. Pra, edhe sikur të ishte 1 ton, përderisa në terrenin ekonomik na del si fenomen që krijon korodim të bazës, atëherë do t'i adresohemi dhe adresimi është shumë i kujdesshëm me 1 mijë lekë.

Erion Braçe – Ky produkt është i listuar gjëkund në bursë?

Arben Ahmetaj – Të gjitha kanë kodet e tyre në atë që quhet markit.

Erion Braçe – Ky produkt tregtohet jashtë?

Arben Ahmetaj – Për sa i përket produktit, për Shqipërinë është pak specifik. Duhet të keni parasysh se në momentin që bie nënproduktet e bitumit automatikisht ka çmime si produkte dhe si nënprodukte, por përtej kësaj, përderisa në terrenin ekonomik unë kam përdorim të një produkti, i cili pavarësisht se tregtohet ose jo ndërkombëtarisht, dhe më zëvendëson një lëndë djegëse, patjetër që do të akcizohet.

Erion Braçe – Kjo zëvendëson lëndën djegëse që prodhohet në vend apo që vjen nga importi?

Arben Ahmetaj – Të dyja.

Erion Braçe – Sa është akciza e lëndës djegëse që kjo zëvendëson?

Arben Ahmetaj – Për shembull, ne iu referuam koksit, që e ka 2 lekë dhe në inicim të politikës e kishim vënë 2 lekë.

Erion Braçe - A është koks kjo?

Arben Ahmetaj – Ka koks të naftës dhe është zhavorri bituminoz, pra nuk janë të njëjtat gjëra.

Erion Braçe – Këtë e kuptoj, por ju në relacione përdorni si koks.

Arben Ahmetaj – Pra, kanë zëvendësuar koksin.

Erion Braçe – Jo, këtë lëndë e quani si koks?

Arben Ahmetaj – Është zhavorr bituminoz, po të ishte koks, do ta kishim vënë koks bituminoz.

Erion Braçe – Pra, kjo zëvendëson koksin e naftës?

Arben Ahmetaj – Po.

Erion Braçe - Këtë po zëvendëson?

Arben Ahmetaj – Kokësi e ka 2 lekë për kilogram, kur e iniciuam me 2 lekë, në fakt, në nacionalitet të Ministrisë së Infrastrukturës, na konsultoi mbrapsht që në qoftë se do ta vendosim 2 lekë, do të jetë shumë e lartë dhe do ta kthejë në të papërdorueshme për industrinë dhe e propozuam 1 lek. Në qoftë se keni ndonjë propozim për ta rritur, do ta diskutonim me kënaqësi.

Erion Braçe – Ne?!

Arben Ahmetaj – Po.

Erion Braçe – Për ta rritur?

Arben Ahmetaj – Po.

Erion Braçe – Po nuk duam t'i bëjmë kaq nder koksit të naftës.

Arben Ahmetaj – Atë e dini ju, por po ta barazoni me koksin e naftës nuk keni krijuar diferencim.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Bushati, u bindët ju?

Ervin Bushati - Te kjo pikë isha i bindur. Pyetjet i kisha bërë më përpara.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime të tjera?

Urdhëroni!

Arben Pëllumbi – Në vazhdim të asaj që tha relatori dhe në kuadër të ndryshimeve që po bëjmë, doja të ndalesha në mënyrë specifike në një politikë të re, që mund të bëjmë në lidhje me llambat. Në raport me energjinë sot ka dy qasje, në prodhim dhe në kursim. Një nga drejtimet e rëndësishme, ku po ecim, është kursimi i energjisë elektrike dhe këtu hyjnë në mënyrë specifike llambat led. Në qoftë se ne do të fillojmë të ndjekim një politikë stimuluese ndaj këtyre llambave dhe jo stimuluese ndaj llambave inkandeshente, të cilat, për hir të çmimit që kanë, sot në vendin tonë kanë një përdorim shumë të gjerë, besoj se do të ishte një rrugë e duhur në të cilën ne mund të ecim drejt uljes së konsumit të energjisë elektrike.

Sigurisht, ende çmimi i llambave led është i lartë, por një politikë e nevojshme në këtë drejtim besoj se do të jepte një ndihmesë në uljen e konsumit, i cili ju them se nuk është aq i vogël i siguruar vetëm nga llambat. Ndoshta kur të vijmë në diskutimin nën për nën ose në një politikë pak më të vonshme, ndoshta vitin tjetër, pra që të ketë një studim të mirëfilltë për mënyrën se si ne mund të adresojmë një politikë fiskale, në ndihmesë të një produkti, i cili ul në mënyrë të ndjeshme konsumin e energjisë elektrike...

Arben Ahmetaj – Zoti Pëllumbi, në përgjithësi këto më shumë trajtohen me standarde se sa me politika fiskale. Pra, shkojmë drejt standardeve të përdorimit dhe minimizimit të përdorimit të inkandeshenteve. Për shembull, kuptohet se nuk është ligji i akcizës, sepse ledi nuk ka akcizë. Inkandeshentja pas kësaj, nëse do ta votoni, nuk do të ketë akcizë.

Në Bashkimin Europian trajtohen nëpërmjet standardeve ambientale apo nëpërmjet standardeve të eficiencës së energjisë. Ne jemi të hapur ta diskutojmë dhe t'i referohemi teknikalitetit të duhur në politikë, promovuese të ledit, gjykojeni ndërkohë jemi duke diskutuar të gjithë paketën në komision.

Erion Braçe – A ka diskutime të tjera lidhur me këtë projektligj? Nuk ka.

Kalojmë te projektligji i fundit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Arben Ahmetaj - Çfarë ka ndodhur zoti Bushati?

Erion Braçe – Nuk ka lidhje me tatimet, tatimet nuk e marrim këtë procedurë..



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Urdhëroni!

Arben Ahmetaj - Po i prekim procedurat tatimore për të vazhduar lehtësimin e procedurave tatimore për tatimpaguesin si objektiva, mbylljen e hapësirave për shmangie tatimore dhe evazion, lehtësimin e komunikimit me tatimpaguesit, duke përdorur më gjerë komunikimin elektronik, por duke e sanksionuar në ligj, lehtësimin nëpërmjet agjencive shtetërore, si DPT dhe QKB, pra Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, duke e parë këtë në funksion të reduktimit të bazës administrative; përmirësimi i rregullave të regjistrimit të pajisjes me NIPT dhe çregjistrimin e personave fizikë tregtarë. Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj lidhen me thjeshtëzimin e procedurave tatimore në zbatim të legjislacionit tatimor. Në përputhje me direktivën propozohet një dispozitë e përgjithshme antishmangie, e cila mundëson administratën tatimore që të përdorë mënyra alternative të vlerësimit tatimor kur konstatohet se taksapaguesi kryen veprime apo transaksione, të cilat synojnë përfitimin e një avantazhi tatimor në kundërshtim me legjislacionin tatimor dhe rezulton fiktive me prova dhe me fakte.

Në lidhje me dënimet për kundërvajtjet administrative tatimore, vlen të theksohet një kthesë me rëndësinë në nenin 124, ku thuhet: “Në rast se tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe paguan detyrimin, gjoba reduktohet me 30%. Synohet përmirësimi i rregullave të regjistrimit dhe të pajisjes me NIPT të personave fizikë dhe tregtarë për të administruar këtë kategori tatimpaguesish, në deklaram të saktë të të ardhurave të realizuara kur fiktivisht ndajnë aktivitetin vetëm me qëllim shmangie tatimi, duke regjistruar me më shumë se një NIPT”, gjë që e kemi parë rëndomtë të ndodhi ku i njëjti person krijon më shumë se një NIPT. E mbyll njërin, e bën njërin pasiv dhe kalon tek tjetri dhe këtu i japim fund asaj praktike.

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati - Faleminderit, zoti Ministër!

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” ka si objektiv kryesor thjeshtimin e procedurave tatimore, rregullimin e mangësive të evidentuara gjatë implementimit, që çojnë në shmangien e pagesave të duhura dhe evazion, mundësimin e

përdorimit në mënyrë alternative të vlerësimet tatimor, si dhe reduktimin e kostove të administrimit të biznesit.

Projektligji në nenet 1 dhe 2 parashikon ndryshimet e neneve 42 dhe 43 të ligjit ekzistues, duke mundësuar përmirësimin e rregullave të regjistrimit dhe pajisjes me NIPT të tatimpaguesit, me qëllim deklarimin e saktë të të ardhurave të realizuara dhe shmangien e evazionit. Në këtë frymë personi fizik mund të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me të njëjtin numër identifikimi personal vetëm një herë dhe mund të pajiset me NIPT vetëm pas çregjistrimit të atij ekzistues. Gjithashtu, për çdo veprimtari të re që kërkon të regjistrohet personi fizik tregtar, do të pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi, të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm për të mundësuar dhe identifikimin e vendndodhjes së kësaj veprimtarie të re.

Neni 3 parashikon rregullime dhe shtesa në nenin 44 të ligjit lidhur me kalimin e tatimpaguesit në regjistrin pasiv. Kalimi i statusit nga regjimi aktiv në regjimin pasiv do të bëhet vetëm pas pagimit të të gjitha detyrimeve tatimore të tatimpaguesit. Ky përcaktim së bashku me përcaktimet e nenet 1 dhe 2, do të mbyllë shtegun për mbylljen e një aktiviteti sa herë që evidentohen detyrimet tatimore të papaguara, duke shtuar kështu nivelin e borxhit të pambledhshëm. Për këtë qëllim QKB-ja do të bashkëpunojë periodikisht me administratën tatimore, do të publikojë edhe listën e tatimpaguesit në regjistrin pasiv, për më tepër çdo transaksion që do të kryhet nga tatimpaguesi e regjistruar në regjistrin pasiv do të konsiderohet si shkelje dhe do të penalizohet së bashku me tatimpaguesin në regjistrin aktiv që ka kryer transaksione me të.

Projektligji përmes nenit 4 të tij, parashikon ndryshimin tërësor të nenit 45, duke përcaktuar, në mënyrë të detajuar, procedurat lidhur me çregjistrimet e subjektit tatimor pranë QKB-së dhe administratës tatimore, si dhe duke përcaktuar detaje lidhur me përcaktimin e datës së çregjistrimit për kategori të ndryshme tatimpaguesish, radhën dhe procedurën e çregjistrimit, afatet e veprimit dhe kushtet specifike për regjistrim, ku riktheqsohet detyrimi për të mos pasur detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore.

Në nenin 5 të këtij projektligji parashikohet rritja nga 100 lekë, në 1000 lekë, e nivelit të shumës së detyrimit tatimor të detyrueshëm për t'u paguar ose e tepicës së kredisë, që vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero, shumë kjo për të cilën nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.

Në nenet 6 dhe 7 të projektligjit parashikohet e drejta e administratës tatimore për të përdorur si mënyrë alternative vlerësimin për rastet kur tatimpaguesi, person fizik, me qëllim

shmangien ose minimizimin e pagesave, mban më shumë se një NIPT ose në rastet kur tatimpaguesit kryejnë një ose disa veprime (transaksione direkte ose indirekte), që deformojnë parimet e ligjit tatimor; nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut kur veprimi (transaksioni) nuk reflekton thelbin e tij ekonomik apo evidentohen veprime (transaksione) që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore. Për këto raste veprimi (transaksioni) rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 8 parashikohet shtimi i një pike në nenin 75 të ligjit bazë, duke krijuar lehtësi të tjera për tatimpaguesit, si dhe duke mundësuar kompensimin nga teprica kreditore e detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore automatikisht nga sistemi informativ.

Në nenet 9, 10 dhe 11 përcaktohet radha e pagesës së kontributeve dhe detyrimeve tatimore, duke filluar me detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj, si dhe mundësohet lehtësimi i procedurave, nëpërmjet përdorimit të gjerë të komunikimit elektronik, thjeshtësimit dhe qartësimit të procedurave të njoftimit për pagesën e detyrimeve tatimore të pagesës.

Në nenin 12 të projektligjit propozohen ndryshime lidhur me procedurat e deklarimit të detyrimit tatimor, si dhe atij të pambledhshëm, fshirjen ose shuarjen e tij, duke parashikuar që fillimi i kësaj procedure mund të bëhet me kërkesën e tatimpaguesit, por edhe kryesisht nga organi tatimor.

Nëpërmjet nenit 13 të projektligjit vijohet me lehtësitë ndaj tatimpaguesit, duke përjashtuar nga pagesat që duhen bërë, si kusht për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë organit tatimor, gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar dhe kamatëvonesat e llogaritura.

Përmirësime dhe saktësime parashikohen edhe në kreun e sanksioneve, sipas neneve 14 e vijues deri te neni 17 i projektligjit, nëpërmjet të cilëve shtohet një pikë në nenin 115, duke trajtuar si deklarim të pasaktë rastet e rivlerësimit në ulje të tepricës kreditore të tatimpaguesit në përfundim të kontrollit tatimor, duke parashikuar një penalitet në masën 20% të diferencës ndërmjet tepricës së kreditorit të deklaruar me tepricën e kreditorit që duhej deklaruar.

Ndër të tjera, shtohet një nen i ri, ai 115/2, lidhur me dënimet që do të aplikohen në rastet e mosnjoftimit të ndryshimeve të pronësisë; shtohet një paragraf në nenin 124, nëpërmjet të cili propozohen lehtësira edhe në trajtimin e kundërvajtjeve administrative, duke

parashikuar uljen e penalteteve në 30% për rastet kur tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, si dhe shtohet një përcaktim në fund të germës “ç” të nenit 129, duke vendosur përkufizime të vlerës maksimale të penaltetit, jo përtej shumës së kërkuar, për t’u bllokuar për dënimet ndaj tatimpaguesve, që janë banka ose institucione financiare.

Të gjitha këto propozime e ndihmojnë shumë jo vetëm administratën, por besoj edhe biznesin, pasi janë të menduara mirë, prandaj ishin edhe të detajuara apo pse duheshin sqaruar, ndaj edhe u shkova deri në fund. Kjo është edhe arsyeja pse nuk kam pyetje apo komente për të bërë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Vazhdoni me pyetjet, zoti Bushati!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni? Në rregull.

Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, ju u zgjatët më shumë sesa ministri për atë punë, por keni pyetje?

Po, urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të dëgjosh fjalët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – ...t’i dëgjojë biznesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Të dëgjosh shprehjen “përmirësim dhe lehtësim procedurash” besoj se është gjithnjë e mirëpritur dhe e këndshme, aq më tepër që këto do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kohën që do t’i duhet biznesit për të harxhuar në lidhje me raportin që ka me organet tatimore.

Pyetja është e shkurtër dhe shumë e thjeshtë: a jeni konsultuar paraprakisht me grupet e interesit? A janë në dijeni të këtyre ndryshimeve dhe si i kanë pritur, meqenëse ne do të kemi ndoshta edhe dëgjesa në këtë aspekt, por për ta ditur paraprakisht nga ana juaj?

Arben Ahmetaj – Siç jua thashë, edhe në diskutimin në parim të projektbuxhetit kemi pasur një konsultim tejet të gjatë me sipërmarrjen dhe e kemi filluar që në prill, madje të detajuar. Shumica e lehtësimeve janë kërkesa të drejtpërdrejta dhe racionale të sipërmarrjes praktikisht. Kështu që, përgjigja është “Po” dhe me shumë dilijencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Po, urdhëroni!

Roland Xhelilaj – Ky është një projektligj shumë i rëndësishëm, në çdo rast i paraqitet paketës fiskale dhe mjafton të përmendim dy objektivat kryesorë, që janë: lehtësimi i procedurave tatimore për tatimpaguesit, sidomos mbyllja e hapësirave është shmangie tatimore dhe evazion. Besoj se kjo i shërben përmirësimit të klimës së të bërit biznes. Megjithatë, duke qenë dakord me relatorin, kisha merakun të trajtoja diçka edhe në kuadrin e një moskuptimi të saktë. Për shembull, në nenin 3, për kalimin e tatimpaguesit në gjendje pasive, theksohet momenti pasi i ka likuiduar të gjitha detyrimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në nenin 3, pas pikës 4, shtohet pika 4/1, ku thuhet: “Kalimi në regjistrin pasiv bëhet duke verifikuar më parë pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e tyre”. Kam një merak, sepse ai që kalon në...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai nuk ka likuiditete. Mos vallë i shtohen detyrimet dhe e çojnë pastaj drejt falimentimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto mund t'i diskutojmë edhe kur të vijmë nën për nen, por edhe këtu...

Arben Ahmetaj – Kjo pikë është tejet parimore. Pse? Ju, me të drejtë, shikoni anën e biznesit, por ne do të na duhet t'i shohim të dyja anët: edhe anën e buxhetit, edhe anën e sipërmarrjes. Çfarë i kërkon këtu administrata dhe ligji atij që tenton të kalojë pasiv? Të ketë paguar detyrimet; asgjë tjetër. Pra, duhet të ketë paguar detyrimet, pa të kalojë në gjendje pasive.

Si mund të kalojë në pasiv kur sot kemi faktin se kalojnë në pasiv sipërmarrje që janë me detyrime? Çfarë bëjnë pastaj? E lënë pasiv, e kalojnë dhe krijojnë një NIPT tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ta shikosh, ne i kemi lidhur të dyja anët e zinxhirit.

E para, nuk e kalojmë në pasiv pa paguar detyrimet dhe, e dyta, nuk e lëmë të krijojë një NIPT të ri, duke i ngarkuar NIPT-in e vjetër me detyrime.

Tani, besoj se ju jeni shumë dakord me mua që kjo duhet bërë. Jam i bindur për këtë.

Roland Xhelilaj – Ne jemi dakord, por e kam merakun vetëm se biznesi në këtë rast duhet të shohë mbështetjen e qeverisë, sidomos të ndërtojë marrëdhënie shumë korrekte me drejtoritë tatimore. Kjo sepse te një pikë aty theksohet që kur kryen transaksione me një

tatimpagues pasiv, kur vetë është aktiv, dënohet me gjobë administrative. Pse ai duhet ta kontrollojë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë bën drejtoria tatimore në këtë rast?

Arben Ahmetaj – Po, edhe ai. Por ne tani e kemi vendosur si kusht...

Roland Xhelilaj – Duket sikur lehtësojmë vetëm njërin krah.

Arben Ahmetaj – ...që lista e pasiveve të përditësohet çdo ditë. Kjo do të thotë që një biznes aktiv, ndërkohë, dhe imagjiloni se sa mirë do të jetë kjo kur të kemi sistemin e fiskalizimit, ku do të jesh online në kohë reale. Bie fjala, ti e di se Landi është aktiv...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju mora thjesht si shembull!

Atëherë, ti e di menjëherë se një biznes është aktiv ose pasiv, sepse ndërkohë do të jetë i përditësuar brenda sistemit të fiskalizimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është pjesë e punës së sipërmarrjes, jo ndonjë shtesë ose kosto. Madje nuk ka as kosto.

Roland Xhelilaj – Kam edhe një merak të fundit.

Në nenin 14 të këtij projektligji...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paraprakisht.

Atëherë, në lidhje me nenin 14 të këtij projektligji “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore”, në mos gaboj, ligji njeh të drejtën e ndryshimit të deklaratës tatimore për 36 muaj. Mos ka një përplasje në këtë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ta mbyllur, duke pasur parasysh se ligji ndihmon edhe Drejtorinë Tatimore për ta kryer sa më mirë punën e saj, kam një merak në plotësimin e vendeve të punës në drejtorinë tatimore që keni nëpër qarqe. Mendoni se numri shumë i madh i vendeve vakante ndikon pozitivisht, apo negativisht në kryerjen e detyrës prej tyre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo pyetje është jashtë projektligjit.

Arben Ahmetaj – Unë nuk kam asnjë merak këtu. Kjo është shumë e saktë, sepse deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti “si rezultat i një kontrolli tatimor”; togfjalëshi bën diferencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – Në parim, në fakt, unë e mbështes...

Erion Braçe – Zoti Bushati është relator dhe është gjithëpërfshirës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – Jam në mbështetje të asaj që po thotë ministri, sepse, në fakt, edhe parimet janë të tilla dhe mbahen si të vërteta, ku shpeshherë rakordohen me shifrat dhe statistikën, pavarësisht rastit më të keq që mund të marrim ne, për shembull, kur dikush nuk ka likuiditete dhe ka rënë në ditë të zeza.

Fakti dhe fenomenet është se ka shumë njerëz, që e bëjnë në mënyrë të përsëritur dhe e kanë si lojë këtë: hapin dhe mbyllin pa paguar. Pra, ky është fenomeni që po përpiqen të evitojnë ministria, qeveria dhe administrata. Janë po të njëjtat firma që hapin dhe mbyllin, i kthejnë në pasive, si dhe i lënë shtetit borxhe të prapambetura. Por ky nuk është dëm vetëm për administratën.

Në radhë të parë, është cenim për konkurrencën e ndershme në treg, sepse janë disa tregtarë ose administratorë të pandershëm, që hapin dhjetë NIPT-e, ndërkohë ai tjetri, që është konkurrent me të përballë, ka po të njëjtin NIPT, i paguan detyrimet dhe nuk lë asnjëherë gjëra pa paguar, pra edhe ai vazhdon dhe qëndron në treg. Kam përshtypjen se ky është parimi që duhet të shmanget.

Erion Braçe – Për çfarë thua?! Aty ka institucione që e bëjnë këtë punë, ti vazhdon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ka edhe të drejtë, por kjo është çështje vullneti, zoti Bushati!

(Deputeti Bushati flet pa mikrofon.)

Ervin Bushati – ...që e kanë ndërtuar mbi të tilla.

Erion Braçe – Këtë thashë unë, jo thjesht biznesi, por edhe institucionet.

Ervin Bushati – Atë nuk e di unë, flas në parim si ligjvënës. Institucionet, thotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka biznese që...

Erion Braçe – Mbaruat me pyetjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se kemi edhe diskutimin nën për nën prandaj.

Ka diskutime lidhur me këtë projektligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Ajo që tha zoti Bushati është themeltare, madje ju falënderoj, zoti Bushati, patjetër, sepse e korodon të gjithë pjesën e bazës tatimore dhe bëhet për herë të parë!

Keni parasysh, besoj...

Më falni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë!

Blerina Gjylameti – Mendoj se është një zgjidhje, të cilën duhet ta kishim... Është e vonuar në kohë, por e duhura, sepse është realisht...

Arben Ahmetaj – Dakord.

Blerina Gjylameti – ...një problem për të cilin ne diskutojmë gjithmonë: “detyrime të prapambetura, detyrime të prapambetura, detyrime të prapambetura”. Ndryshon? Edhe unë e vlerësoj shumë.

Arben Ahmetaj – Kemi analizuar një emër me shtatë NIPT-e. Në aspektin normal të aktivitetit ekonomik, mund t’i kishte, se kishte biznese të ndryshme, por ndërkohë fenomeni mbyll njërin, tjetrin e kalon pasiv, më vonë kërcen përsëri tek i njëjti biznes, por me një NIPT tjetër, pastaj bën të njëjtën gjë... Ky është evazion i fenomenit të strukturuar komplet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet për herë të parë.

Për ta mbyllur, diçka tjetër që dua ta ndaj me ju është neni 7, që bën ndryshime në nenin 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit”, ku thuhet: “Në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimet me parimet e ligjit”. Dua të ndaj me ju këtu se me vendim të Këshillit të Ministrave, kur t’i detajojmë, do të jenë praktikatat më të mira ndërkombëtare në referencë të direktivave. Pra, nuk do të shpikim asgjë. Të mos sillemi sikur po shpikim ndonjë gjë të madhe. Praktikisht do të mbyllem një shteg në të gjithë digën fiskale kundër evazionit, por duke iu referuar direktivës dhe praktikave të shëndosha dhe atyre më të mira ndërkombëtare. Faleminderit!

Unë e mbylla pjesën për këtë ligj.

Erion Braçe – Faleminderit!

Atëherë, edhe diskutimi i këtij projektligji mbyllet këtu. Bashkë me këtë ligj mbyllet edhe paketa fiskale.

Falënderoj dy relatorët e komisionit për nxitjen e diskutimit dhe debatit në Komisionin e Ekonomisë, për më tepër, zotin Bushati, që më në fund ia doli të marrë një falenderim të sinqertë për opinionet e tij gjatë kësaj dite.

Ditën e hënë do të fillojmë me shqyrtimin e buxhetit në parim. Kalendari i punës së komisionit do të jetë ky: ditën e hënë do të fillojmë me diskutimin e të ardhurave në parim, ditën e martë do të diskutojmë po në parim shpenzimet e projektbuxhetit për vitin 2019, ditën e mërkurë do të diskutojmë në parim për deficitin buxhetor dhe borxhin publik, parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2019 dhe ditën e premte do të diskutojmë për koncesionet dhe faturën e tyre të parashikuar në buxhetin e shtetit për vitin 2019.

Kam dy gjëra për diskutimin që do të fillojmë javën tjetër.

Zoti Ministër, së pari, po përsëris edhe një herë kërkesën për tabelën fiskale në format të lexueshëm, sepse, për të thënë të drejtën, mbledha sot një grup kolegësh pa syze dhe me syze si unë dhe nuk i lexonim dot numrat.

(Arben Ahmetaj flet pa mikrofon)

Nuk lexohet tabela, zoti Ministër.

(Arben Ahmetaj flet pa mikrofon)

Ne jemi mësuar të punojmë me letra.

(Arben Ahmetaj flet pa mikrofon)

Ne kërkuam tabelën fiskale me të dhëna nga viti 1996 deri në buxhetin e tanishëm apo me aktin normativ dhe natyrisht edhe për tre vitet në vijim, me qëllim që të kuptojmë edhe ne trendin e të dhënave në vite.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në formatin që po tregon zonja Gjylameti.

Të jenë të dhëna të lexueshme, sepse, për të thënë të drejtën, në formatin që kanë ardhur, nuk lexohen.

(Arben Ahmetaj flet pa mikrofon)

Patjetër.

Arben Ahmetaj – Tabelën fiskale që nga viti 1996 jua kemi dërguar me *e-mail*.

Erion Braçe – Mua nuk më ka ardhur gjë.

Arben Ahmetaj – Ia kemi dërguar të gjithë anëtarëve të komisionit, megjithatë do ta verifikojmë përsëri.

Erion Braçe – Unë e kontrolloj *e-mail*-in çdo 3 minuta dhe nuk më ka ardhur.

Arben Ahmetaj - Ju ka ardhur që në muajin tetor, kryetar. Megjithatë, nuk ka rëndësi.

Erion Braçe – Tabela fiskale nuk ka ardhur. Në tetor na ka ardhur vetëm muaji koherent, që kërkoi zonja Tabaku.

Arben Ahmetaj – Ka ardhur që nga viti 1996, por nuk ka rëndësi. Do ta ridërgojmë sot.

Këtë e doni me *e-mail*, apo jo?

Erion Braçe – Jo, atë nuk e duam me *e-mail*. E kemi marrë.

Së dyti (*është kërkesë e relatorit por edhe imja*), për shkak se do të shkojmë te diskutimi i të ardhurave të buxhetit, por edhe te diskutimi nën për nën i projektligjeve, veçanërisht për ligjin për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar, na intereson të kemi tatimin mbi të ardhurat personale të detajuar sipas natyrës së të ardhurave personale. Domethënë, të ardhurat nga paga bashkë me vlerën respektive më vete, të ardhurat nga dividendi më vete, të ardhurat nga aksionet më vete, të ardhurat nga qiratë më vete.

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Po pra, sipas kategorive bashkë me vlerat, sepse do të na duhet t'i përdorim gjatë diskutimit që do të kemi.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu për t'u hapur të hënën në orën 10:30.

MBYLLET MBLEDHJA